




**KUVENDI I KOMUNËS-SUHAREKË
SKUPŠTINA OPSTINE - SUVA REKA
MUNICIPALITY OF SUHAREKA**



I mbajtur me rastin e mbledhjes së VI (gjashtë) për vitin 2026 të Komitetit për
Politikë dhe Financa të KK Suharekë

Vendi: KK Suharekë
Zyra: Salla e Bordit të Drejtorëve
Data: 22.06.2026
Ora : 10:00

Prezentë:

Z. Bexhet Kuçi - Kryesues

Të pranishëm tjerë:

z. Flamur Bytyçi

z.Enver Shabani

znj.Mimoza Bajraktari

znj.Sanie Kuçi Rexhepaj

znj.Laureta Tafaj

z.Dardan Berisha

Habibe Bytyqi - Zyrtare për barazi gjinore

Zyra për informim

Përfaqësues i OSBE-së

Përfaqësues i LMT-së

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit z. Bexhet Kuçi i cili propozoi këtë:

Rend Dite

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e kornizës afatmesme buxhetore për Komunën e Suharekës;**
- 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për shpalljen interes i përgjithshëm publik të pronave private;**
- 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës;**
- 5. Shqyrtimi i projekt-vendimit për përcaktimin e vlerës së bonus banimit ;**
- 6. Shqyrtimi i projekt-vendimit për caktimin e lokacionit dhe dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës;**
- 7. Shqyrtimi i raportit të auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Suharekës për vitin 2025;**
- 8. Plan i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga Zyra Kombëtare e Auditimit;**

Kryesuesi-e hedhë ne votim rendin e ditës

Unanimisht miratohet

Pika 1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesi-e hedhë në votim

Unanimisht miratohet

Pika 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e kornizës afatmesme buxhetore për Komunën e Suharekës;

Kryesuesi-e elaboron pikën dhe hap debatin

Flamur Bytyçi-përsendetje për të gjithë,unë kam kërku edhe herav të tjera që Drejtorat me qenë prezent,përshkak që ne kemi pyetje në lidhje me pikat e rendit të ditës sidomos tek qështja e

kornizës afatmesme buxhetore unë i kam disa pyetje dhe nuk kam me kan me debatu pasi që Drejtoresha mungon.

Laureta Tafaj-përshendetje për të gjithë,po mendojë që e kemi hup kuptimin e këtij komisioni dhe unë qysh e shoh ky komision bëhet si një lloj grupi punues ku ne mbledhemi japim ide propozime punojmë bashk dhe në fund qato materiale me korigjime qka nuk na doken mir i përcjellim për Asamble,këshillat tona që po i japim nuk po na marrin parasysh,ne këshilltar komunal e kemi emrin veq të till nuk po jemi,unë që sa kohë shpërndarje më të dobët se kjo korniz nuk kam pa nuk e di a ka ndodh për ndonjë inat politik a qka ka ndodh nuk e di ama sot pak para se me ardhë këtu e takova një qytetarë të fshatit Savrovë, 3 rrug jan aty “Rifat Halimi, rruga është kontest gjyqësor,ndërtimi i rrugës “Livadhet e buta”në Savrovë ai thot që sa kohë është dëmtu edhe ara e tij por kurr nuk është pun veq është grry e kurr nuk është pun që sa koh,ndërtimi i rrugës “UÇK” degëzim Savrovë ata ma përshkruajtën që është e përfundume mbasi që nuk jan Drejtorat këtu e diskutojmë në Asamble,në Greikoc ekstrem pak buxhet pasi që Greikoci është fshat i madh ,2-3 rrug as ndriqim publik ka vite që e kërkoj ka rruga e Shkollës për siguri të nxënësve nuk më është ndëgju zani kurr pse ndoshta që jam opozit por jo jam këshilltar Komunal e barabart me anëtarët e juj të pozitës tjetra,ka vler deri në 30.000€ këtu që nuk jan të specifikume,rrug lokale në këtë vend,ndriqim ,sanime në tri vende dikun 800.000€ jan ndriqim kanalizim në tri fshatra me një kod,probleme teper të mëdha.

Dardan Berisha-përshendetje për të gjithë,dëgjimet publike kan fillu për një jav dhe jan kry 42 fshatra dhe e dijm që kan qenë zgjedhjet dhe ne e mirkuptojm këtë pun që jan nda në grupe,un ju kam than ne fillim një pjesë të përgjegjës e kemi edhe ne qe jemi të zgjedhur prej qytetareve me shku në dëgjimee publike,me pas qen brenda dy jave ndoshta kemi mujt me i përcjell mirpo ne kete form jo,vetëm neper fshatrat tona ku kemi qen nuk jan projekte e propozuara prej qytetareve dhe prej neve si Asambleist,sepse un nëse jam i zgjedhur si Asambleist i një fshati që kam marr pjes ne degjim puiblik dhe mos me qu një projekt kjo nuk është e natyrshme mos me u marr parasysh propozimet tona,ajo qka më shqetëson ne kete korniz disa projekte të cilat jan të përfundume dhe figurojn prap kjo rregullore duhet të rishikohet.

Njëra nga arsyet që po zgjatet seanca është kjo që në kpf nuk po hargjohen diskutimet sepse nuk po jan Drejtorat sepse ne duhet me bashkpunu edhe me grupin dhe ne seanc të rregullt me ardh me qëndrim të qart.

Sanie Kuçi Rexhepaj-përshendetje për të gjithë,pak a shumë të gjitha ato që i përmbledhi Dardani pata me i than edhe unë dhe nuk po du me qenë shumë e përseritu,por Kryesues na një çështje po e harrojm dhe po e anashkalojm që obligim për me hartu buxhetin nuk e ka vetëm Ekzekutivi e ka edhe KPF por KPF nuk është tu u përfshi në proces të hartimit të buxhetit,i vetmi takim që mbahet me KPF për tem takimit obligativ që e kemi për pikat e rendit të ditës,dmth nuk është epiqendra buxheti por jan krejt pikat e rendit të ditës është në fillim të Shatorit kur e marrin pak para seancës që duhet me u miratu dhe ajo është shumë e vonshme sepse është po thuajse punë e kryme dhe po e mbajmë për formalitet,për formalitet mbahen edhe ndëgjimet publike me qytetarët ndonëse jan kry mbrenda një periudhe shumë të shkurt dhe jam shumë e sigurt që nuk keni hartu as raport me i përmbledh krejt kërkesat e qytetarëve me pa qka mundeni me përfshi e qka jo brenda për brenda buxhetit,nuk e keni përfill vetëm keni dasht me kry si obligim ligjor pak a shumë me than që po ndëgjohen qytetarët por nuk jan tu ndëgju dhe për këtë arsye nuk jam pjesë e dëgjimeve publike për buxhet sepse e kam pa që i keni veq formalitet.Puna e Drejtorave është fakt që mungojnë secilën mbledhje të KPF-së,Kryetari mungon është jo seriozitet por është pak edhe arroganc e numërave ,përshkak se unë jam tu i përcjellë 3 mandatët e Kryetarit Bali Muharremaj dhe mandati par e din edhe ti Kryesues vetë kur se keni pas shumicën e votave në Asamble dhe qysh ka

shku,KPF ka qenë një mundësi qysh me i bind anëtarët e KPF-së që ajo pik që Drejtoresha Sanie e ka propozu për pik të rendit të ditës për me kalu në Kuvend Komunal dmth ka qenë kogja një far përgjegjësie me ardh këtu me prezantu para anëtarëve të KPF-së,e prej momentit që u bë shumica e Aleancës në Kuvend bashkë me PDK-në njëfar rehatllëku i Kryetarit bashkë me Drejtorat dhe është mosrespekte dhe po i humbë vlera e punës së Asambleistave.Sa i përket buxhetit është pak shqetësuese qekjo pjesa e përsëritjes së projekteve dhe un nuk e di qysh po vazhdohet mënyra e hartimit të buxhetit se Drejtori i ri tash ka ardhë dhe nëse ju kujtohet në seancat e kalume ka thënë që për vitin e kalum e kam trashëgu të gatshëm buxhetin e 2025 sepse është miratu në 2024,ta shohim me ndryshimet e reja në mënyrën e hartimit të buxhetit gjatë vitëve të ardhëahme,më shumë po më intereson a ka ndryshu diqka në metodën e hartimit të buxhetit apo është e njëjta çështje jo seriozitet,në shumë projekte psh Drejtoria e Shërbimeve Publike merret më shumë me çështjen e rrugëve, ndriqimit kanalizimit e ka qytetin,fshatrat pe shoh mandej të Drejtoria Urbanizmit ndërtimi dhe rikonstruimi i rrugëve në zonën urbane në Suharekë dhe këto rrug a nuk i ka të planifikume edhe Drejtoria e Shërbimeve publike sepse unë pe shoh që jan,qka ka me ba Drejtoria e Urbanizmit në ndërtim të rrugëve por le të merret më shumë me planifikim dhe me çështje urbane pse duhet me ndërtu rrug nuk po e kuptoj,dhe te rikonstruimi kjo çështje a nuk ka me kalu tash te Eko-Theranda,mandej te ndërtimi i zonave infrastrukturore Smart në Suharekë kalojn këmbësorët zebrat ky projekt është tu planifiku që 6 vjet,konkretisht qka keni ba te zebrat që 6 vjet që qdo vit është e planifikume qekjo çështje e qka tash e tutje,dhe në projektet tjera me një kod të qytetit përfshihet edhe instalimi i ndriqimeve publike por edhe rrjeti kanalizimit qysh mundet e njëjta kompani me i marrë te dya këto projektet kur jan qështje të ndryshme,pse jan planifiku brenda për brenda një kodi dhe pse nuk është specifiku ku qysh edhe tek,dmth çështja e ndriqimit është problematik në krejt tu i marrë parasysh kontratat e deri tashme qysh kan shku dhe në formën qysh jan përmbyll.

Kryesuesi- e hedhë në votim

4 për,3 kundër miratohet

Pika 3.Shqyrtimi i projekt-vendimit për shpalljen interes i përgjithshëm publik të pronave private;

Kryesuesi- e elaboron pikën dhe hap debatin

Laureta Tafaj-po dukët që është në interes të Komunës ama nëse ka diqka tjetër që fshihet mbrapa ksaj ne nuk e dijm,mbi gjithatë qysh po prezantohet mendoj që duhet me kalu dhe është në interes të Komunës.

Sanie Kuçi Rexhepaj-mas pari është mirë Ben-center ose qysh e ka emrin e firmës me i thënë me i pagu niher borxhët të parcelës që e ki në Zonë industriale që e ke marr që tri vite e planin investiv ke pas me kry brenda dy viteve dhe hala nuk e ke përmbyll e mandej me ja marr për baz kërkesat të tjera,e para mir është rrug që jan të planifikume dhe jan të shfrytëzume mir jan me u pastru kuptimin e pastrimit nga parcelat private se ajo parcel private është tu u shfrytëzu nga krejt qytetarët në aspekt të rrugës dhe duhet ndoshta me u shpronësu dhe krejt kjo çështje me u rregullu,çështjet pronësore jan problematika më e madhe në Republikën e Kosovës jo veq në Suharekë dhe këto duhet me u rregullu,parcela ku po mendohet me u këmbu në të ardhmën se ne sot jemi tu diskutu vetëm për shpalljen e interesit të përgjithshëm,ajo zon po shpallet interes i përgjithshëm por ju neve nuk na keni bashkangjit pjesen e dyt të çertifikatës së pronës që tregon qajo pron aty e kujt është,plus asaj un e di që plani rregullues i hollsishtëm për zonën industriale e

kemi shfuqizu në mandatin e kalum,ajo pjesë të ardhmen është e dedikume për gjelbërim tash është pjesë e zonës industriale,unë e di edhe atë pjesën që Ministria e Financave e bën vlerësimin e pronës,kshtu që ajo pjesë ku po pretendon me marr Ben-center është shumë më e madhe nga kjo që po e jep plus asaj kjo është rrugë e ajo zonë ndërtimore kështu që spo e di a mundemi me kry punë taman qysh duhet,thjeshtë mënyra qysh është parapa nuk po me jep përshtypje të mirë.

Flamur Bytyçi-çështja e Zonës sinjerisht është kriminalizu si në aspektin e përgjegjësi të juv si Ekzekutiv të lejimit të tepërt të individëve të caktum që nuk i kanë kry obligimet të njëjtë an as një inspektim,unë jam pro me dhënë në shfrytëzim secilen pronë të Komunës por jo me keqpërdor tash e sa vite,ajo qka po më vje qudi ku po e merrni guximin me vazhdu kështu hala a e mendoni ndonjëher pasojat ligjore si Ekzekutiv,në të ardhmen e afert unë po besoj që secili prej jush që keni pas guximin me bënë kështu në Zonë industriale një ditë keni me dal para përgjegjësis.

Sanie Kuçi Rexhepaj-emri i pronarit këtu të Ben-center është Elona Kuçi por qirambajtja nuk është pronar i përhershëm por në qirambajtje për 99 vite,sa kena drejtë na me shpall interes të përgjithshëm,por tani qysh po i jepet pjesa tjetër apo bëhet pronar i përhershëm apo në qiramartje për 99 vite,kur këmbëhet në pjesën tjetër qysh po mbetet ose Komuna kur e merrr këtë pjesën e rrugës apo bëhet pronar i përhershëm apo në qirambajtje për 99 vite?

Amir Hoxha-këtu Drejtoria e Shërbimeve Publike e ka zgjeru atë rrugën aty e ka marr pronën në shfrytëzim,e rëndësishme është një herë me u shpall interes publik pastaj me u punu sakt,a duhet në tash me ja hek atij prej AKP-së dhe me u marr në me AKP sepse nëse bëhet pronar faktik i asaj e kendej 99 vite është punë që duhet me u trajtu më tutje,mirpo njëher është e rëndësishme që Zona industriale është zgjeru dhe punët që nuk janë kry atëher për krejt këto procedurat që ne po diskutojm tash.

Sanie Kuçi Rexhepaj-a mundemi në paraprakisht me i bënë konsultimet me ekspert të çështjes dhe mandej ne i dijmë hapat që duhet me i ndër marrë sepse mundesh me shku në rrugë pa kry dhe me u kthi në pikën 0.

Flamur Bytyçi-unë nuk po pajtohem me atë se pse me nis një procedurë pa ditë që tu i pas krejt opsionet ju e keni pushtetin absolut këtu dhe mundeni shumë kjasht me sqaru këtë punë që mos me ardh ky vendim në Asamble me kalu dhe me kthi Ministria përshkak të problemeve ligjore dhe unë mendoj që ky vendim ka me u kthi prej Ministrisë dhe nuk funksionon kështu dhe qysh e tha Drejtori që mundemi me bënë pse nuk e keni bënë për damperin dhe me ja dhënë në Duhël mbasi që koka aq e kollajshme sa po e bëni ju.

Laureta Tafaj- e kam një propozim a mundemi në sot me largu prej pikës të rendit të ditës dhe ti në Asamble e largon e rregulloni si çështje e bjerni në KPF-në tjetër dhe e dërgojmë të mirëfilltë në Asamblen e ardhshme.

Kryesuesi-e hedhë në votim

4 për,2 kundër,1 abstenim miratohet

Pika 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës;

Kryesuesi-e elaboron pikën dhe hap debatin

Kryesuesi- e hedhë në votim

Unanimisht miratohet

Pika 5. Shqyrtimi i projekt-vendimit për përcaktimin e vlerës së bonus banimit ;

Kryesuesi- e elaboron pikën dhe hap debatin

Mimoza Bajraktari-përshendetje për të gjithë,këtu te bonus banimi 50% a është e mundëshme me e caktu një shumë psh 250€ 300€ jo me qenë e njëjtë për të gjithë psh dikush e merr banesen 100€ dikush 200€ nuk është e përceptume.

Avni Bytyçi-përshendetje për të gjithë,ky 50% i përcaktimit krahasim në të kaluarën ka ndryshu sepse kish ndryshu edhe ligji për çështjen e financimit të bonus banimit,ligji e specifikon shumë kuartë që lejohet maksimumi 50% dhe nuk ka as më pak as më shumë,në bashkëpunim me Kryetarin kemi parapa edhe për këtë vitë ti subvencionojmë 15 familje,që kur e kemi bënë një kalkulim dikun ka 250€ e ka rrok 25.000€ për krejt vitin ,ligji dhe udhëzimi e obligon Kryetarin ta themeloj një komision dhe komisioni e bënë thirrjen publike dhe familjet që aplikojnë dhe e fitojnë të drejtën Komuna i subvencionon.

Sanie Kuçi Rexhepaj-ne këtë tem diskutimi e kemi pas edhe te grupi i grave dhe në fakt po na jep përshtypje që nuk po bëhet një vlerësim shumë i drejtë ndaj familjeve që janë social,dhe familjeve tjera që kanë mundësi përfitimi përshkak që dikush ndoshta është në varfëri pak më të skajshme e ka shumë problem ndoshta me gjet një banesë pak më të përshtatshme se Komuna ndoshta po ja pagun gjysmën por ai menxi i gjenë 50% tjetër anën tjetër dikush mundet me marrë me 400€ dhe e ka më të lehtë sepse 200€ tjera ja pagun Komuna,tu e pas parasysht pak këtë konceptë qka mundet me ndodhë sepse janë veq 15 familje ndoshta për mendimin ton që ne e kemi diskutu në grup e pam të arsyeshme që me kanë një vlerë mesatare e mbështetjes pa marrë parasysht banesës që veq e ka familja sesa në këtë form të 50% të vlerës nëse është diqka ligjore dhe ne nuk kemi qka flasim më tutje por nëse është e mundëshme me provu të paktën njërin prej vitëve se qysh po funksionon sepse qashtu po na jep përshtypjen që nuk po bëhetnjë vlerësim i drejtë.Ne e pam që është shtu edhe pjesa te viktimat e dhunës në familje dhe një pjesë e kategorisë që financohet vetëm te këtu tek familjet me një prind a përfshihen nanat vetë ushqyese te kjo pjesë.

Dardan Berisha-ky vendim na vjen qdo vit,ne fillimisht duhet me pas edhe një far raporti se deri ku ka shku procesi kush ka qenë në komision dhe sa familje kanë qenë përfituese,se ne si Kuvend po diskutojm dhe kemi mundësi me zbrit numrin e përfituesve dhe mu ndërlihd kjo idea që me dal me një shumë 300€ me rrit shumën dhe me zvoglu numrin e përfituesve ,a po ka shumë kërkesa,a po shtohen rastet sociale më shumë se viteve paraprake për me ditë se qfar vendimi me marrë.

Laureta Tafaj-kërkoj nga Drejtoresha e Shëndetësis me na sjellë një raport në Asamble dhe kriterët e komisionit të cilat janë.

Kryesuesi- e hedhë në votim

Unanimisht miratohet

Pika 6 Shqyrtimi i projekt-vendimit për caktimin e lokacionit dhe dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës;

Kryesuesi- e elaboron pikën dhe hap debatin

Laureta Tafaj-mendojë që ne duhet me dhënë në shfrytëzim se është në të mirën e qytetarëve, mirpo qysh po kërkojnë ata prej neve me marrë këtë dhe ne duhet me dhënë se është për të mirën ton mirpo asnjëher nuk po e kryen shërbimin qysh duhet ne vazhdimisht po kemi telashe me ta, rryma është shumë e dobët dhe ne a mundemi me kërku përgjegjësi prej tynve qysh po kërkojnë sta lokacionin prej neve.

Dardan Berisha-është shqetësimi i njëjtë, shërbimet janë shumë të dobëta dhe ka kërkesa të jashtëzakonshme që neve nuk na marrin parasysh Kedsin.

Flamur Bytyçi-një pyetje vlerën e pagesës mbi bazën e qkafit e përcaktojnë?

Avni Bytyçi- ne e kemi një rregullore për përcaktimin e tarifave për dhënjën në shfrytëzim të pronave në lokalitete që janë në largësi dhe vlerësum që me qenë 20 cent m², nuk është që përfiton diçka Komuna por vetëm le të përfitojnë qytetarët.

Enver Shabani-nuk janë bash të pa përgjegjshëm, nëse dikush bën një kërkesë me shkrim në Drejtorin e Shërbimeve publike zyrtari që është për komunikim me kompanit publike këtë rast me Kedsin dhe ata e kanë një sektorë që i marrin përbaz ankesat e qytetarëve dhe nuk ka ndodh që mos me u përgjigj andaj le të bëjnë kërkesa dhe Kedsin i merrë parasysh.

Sanie Kuçi Rexhepaj-më duket që mandatin e kalum kemi dhënë në shfrytëzim, një pyetje e kam sepse është hera e parë si Asambleiste që jam tu deshtë me miratu një qësi lloj investimi cilat janë rastet kur drejtëpërdrejtë jepet prona në shfrytëzim si në këtë rast sepse zakonisht duhet përmes procedurave, ose ankandit kujt i jepet si Kedsin në këtë form drejtëpërdrejtë në shfrytëzim?

Avni Bytyçi-ligji për dhënjën në shfrytëzim si rregullore e përcakton shumë kjashtë kush ka të drejtë me i dhënë për raste të veqanta ky është rast shumë i veqant pa procedur duke anashkaluar procedurat, mirpo tash fatmirësisht që jepet me pages.

Kryesuesi-e hedhë në votim

Unanimisht miratohet

Pika 8 Shqyrtimi i raportit të auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Suharekës për vitin 2025;

Kryesuesi- e elaboron pikën dhe hap debatin

Flamur Bytyçi-pavarsisht që ne jemi opozitë dhe po ndihem keq që qeverisja Komonale po anashkalon vendimet e Asamblesë, një pjesë e mirë e kabinetit qeveritar jeni të shkollum me lan Kryetarin me bë kështu gabime po besoj që një përgjegjësi e fajit bjen prej Nënkrjetarës e te poshtë te Kabineti nuk kisha dashtë asnjëherë me pa kështu lajme nëpër gazeta për Komunën pikërisht për anashkalimin e Asamblesë për mu është fyerje dhe për qytetarët e Suharekës dhe mos të flas për të gjeturat e tjera. Për qe po ofendohet Asambleja kjo nuk don diskutim ne e kemi pa edhe atë ditë për 13 Qershor kur janë nda qmimet mos me kanë në gjendje ti si Kryesues me nda një mirnjohje përderi sa na kemi votu secili prej neve me gjithë respektin të Kryetarit, Nënkrjetarë ti e ke vendin e veqantë je përfaqësues i joni ne të kemi votu dhe secilën herë ky Ekzekutiv e ka ofendu Asamblenë.

Laureta Tafaj-po thu që nuk është gjithqka zi e vertetë që nuk është, por kur po këkojmë ne fdiçka nuk po na merrni parasysh dmth opozita nuk merret parasysh thu që nuk egzistojm, vana veq për me bë zhurëm mirë e qesim në votim nëse kalon mir nëse nuk kalon, e kjo është qe ne nuk mujna me i tregu të bardhat e juaja se ju nuk na përfillni neve tash të bëhemi të barabart, 3.000.000 euro keqëklasifikim hajde 30.000 euro po hutohi veq 3.000.000 euro veq kur përmenden, për Kuvendin Komunal e tha edhe Flamuri kjo është e tepërt, në media kur e kemi pa e kemi bashkëndj me juve

pamvarsisht që nuk na keni vlerësuar asnjëherë me i marr vendimet e tona kemi qenë pjesë e këtij Kuvendi dhe kjo aspak nuk është në rregull.

Sanie Kuçi Rexhepaj-ky raporti i auditorit është raporti më i keq për Komunën prej krejt raporteve të deri tanishme,nuk është që Komuna nuk është tu funksionu me përgjegjësi 100% me procedura ligjore e dijë vetë kam qenë pjesë Ekzekutivit dhe e di që është kështu vështirë me i ndjek secilën procedurë me hapat taman qysh duhet por disa prej rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit është shumë shqetësuese Kryesues disa janë të kuptueshme se ndodhin secilin vit por pjesa e mospërfilljes së Kuvendit është shqetësimi që duhet me u prek krejtë Asambleistave,nuk po përfillet Kuvendi Komunal,me qfarë guximi Kryetari Komunes merr vendim që nuk i takon ligjërisht me marrë,prej kurit ai është bërë Kryetar i Kuvendit? Prej kur e mor detyrën tënde prej kur e mor nënshkrimin tand? Sepse një detyrë që nuk i takon atij qysh po guxon me bërë,kjo duhet me kan alarm,tjetra çështja e pagesave dmth vonesat në çështjen e pagesave në një mbledhje të KPF-së e kemi pas diskutim në momentin qysh i dorëzohet pagesa që kthehen mjetet,kjo është qdo vit bëhet e njëjta gjë,zyrtarët që janë zyrtarë financiar për secilën Drejtori pse nuk e marrin përgjegjësin nuk janë mjetet ktheje faturën,kur vin mjetet e sjellë faturën sepse është shumë procedurë e thjeshtë sepse zyrtari financiar qatë detyrë e ka me bërë mi kry pagesat me ba alokimin e mjeteve sepse qdo vitë është i njëjti rekomandim prej zyrës kombëtare të auditimit.Në këtë raport qartë shihet kush është fajtori,me pas fuqinë e Kuvendit me i pas votat dhe prap me i marrë vet vendimet dhe mos me kalu përmes procedurave qysh duhet.Mospërfillja e procedurave ligjore është shumë shqetësuese.

Kryesuesi- e hedhë në votim

Unanimisht miratohet

Pika 8.Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga Zyra Kombëtare e Auditimit;

Kryesuesi- e elaboron pikën dhe hap debatin

Sanie Kuçi Rexhepaj-sa seriozisht e keni marrë raportin e Auditimit po shihet qartë edhe te ky plani veprimit,dmth ky plan vetëm plan nuk më duket vetëm sa me heqë obligimin ligjor dy fjalë për secilën pikë.Sa seriozishtë është që prej 1 Korrikut e deri në fund vitë me u marrë seriozisht me këtë çështje sepse krejt pikat fillojnë prej 1 Korrikut dhe deri me 31 dhjetor përfundojnë,sa ka me marrë Ekzekutivi seriozisht këtë çështje kemi me pa vitin e ardhshëm kur ta diskutojmë planin e veprimit të ardhshëm ku kanë me u përsërit komplet këto çështje.

Laureta Tafaj- te çështja B1 do ti sugjerojmë thesarit sugjerime, te B2 thotë ligji për ndarjen buxhetore thotë qartë se qdo për rialokim duhet të kalojë nga Asamblea veq 5% me sa dijmë na kanë drejtë me qenë ndryshe,te kjo e mërgimtarëve po më intereson më shumë dmth është fajësu mërgimtari pse su kanë këtu,për mungesën e numërave personal të 238 tatimpaguesve menaxhmenti arsyeton që mbi 50% e popullatës jetojnë jashtë vendit dhe është e vështirë të kontaktohen,dmth ata i kanë fajet që nuk kanë ardh në pushime por ata sa herë të vijnë nxerrin pasaporta,por ju e dini kohen e pushimeve që mundeni me shku dhe me ja u marrë numërat personal.

Kryesuesi – e hedhë në votim

Unanimisht miratohet

Takimi përfundoi: 11:40